



Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës
Press Council of Kosovo
Savet Štampe Kosova

**10.01.2018, Prishtinë,
Ref:24.10.2017\579-2017**

**Opinion i Këshillit të Mediave të Shkruara të Kosovës ndaj
ankesës së Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot**

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës, në mbledhjen e bordit të mbajtur më 19 dhjetor 2017, shqyrtoi ankesën e Devolli Group kundër gazetës Kosova Sot lidhur me artikullin "Vota kundër Shpendit, votë kundër mafisë dhe krimit", botuar më 6 tetor 2017, dhe nxorri këtë

O P I N I O N

- Ankesa miratohet

A R S Y E T I M I

Në ankesë thuhet se gazeta Kosova Sot përdorë gjuhë denigruese duke e quajtur kompaninë Devolli si "përfaqësuese e grupit kriminal", "bandë serbe", dhe fyerje të tjera.

Gjithashtu, në ankesë thuhet se për asnjë nga këto shpifje dhe dezinformata që i thuhën kompanisë Devolli, gazeta nuk ka dhënë, dhe as që është munduar të jap mbështetje me argumente.

KMShK, pasi e shqyrtoi ankesën dhe artikullin e lartëpërmendur vendosi se gazeta ka bërë shkelje të Kreut II (Raportimi i së vërtetës), pasi që ka botuar vetëm prononcimet e një grupi të analistëve të saj, pa i mundësuar edhe kompanisë Devolli që të prononcohet ose ndonjë organi kompetent apo ndonjë burimi të pavarur në mënyrë që të krijohej një pasqyrë më e qartë rreth temave që i ka shqyrtuar në artikull. Në këtë mënyrë edhe lexuesi do të përfitonte duke pasur parasysh se do të krijohej një spektër i gjerë i pikëpamjeve dhe fakteve në të mirë të së vërtetës.

Gjithashtu, KMShK konstatoi se gazeta nuk ka botuar asnjë prononcim të palës tjetër për çka ka qenë e obliguar sipas Kodit të Mediave të Shkruara, me çka do të përmbushej obligimi që del nga Kreu IV (E drejta për t'u përgjigjur) i Kodit të Mediave të Shkruara.

Bazuar në atë që u tha më lartë, KMShK vendosi si në dispozitiv të këtij opinioni.

Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës